



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Datë : 13.04.2023
Malishevë

13-04-2023
08/03

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të gjithë bletarët e Komunës së Malishevës, të cilët posedojnë bletë që të aplikojnë për subvencione në lëmin e Bletarisë-Pagesa Direkte:

Kriteret e konkurimit:

1. Aplikuesi duhet të jetë banor i Komunës së Malishevës
2. Të ketë së paku pesë (5) e më shumë shoqëri bletësh (në përjashtim të nukleuseve)
3. Shoqëritë e bletëve duhet të jenë të vendosura në një bletishte, dhe brenda territorit të Komunës së Malishevës.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e shkruar nga vetë bletari ku duhet të deklaroj numrin e saktë të bletëve që posedon dhe numrin kontaktues të telefonit.
2. Kopjen e letërnjoftimit.
3. Konfirmimin e llogarisë bankare (në emër të aplikuesit).
4. Vërtetimin mbi tatimin në pronë.

Afati i aplikimit nga data 13.04.2023 deri më 28.04.2023

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën e pritjes.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drejtori:

Sylë Dukolli ecc.dip.



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Datë: 13.04.2023
Malishevë

13-04-2023
00/00

Projekti Komunal për përkrahjen e fermerëve (blegëtorve)

Në kuadër të Zhvillimit të bujqësisë - blegëtorisë, Komuna e Malishevës respektivisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural publikon:

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohën të gjithë fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin Komunal të përkrahjes së blegëtorisë së imët (**Dele dhe Dhi qumështore**), me Pagesa Direkte.

Kriteret e konkurimit:

1. Fermeri duhet të jetë banorë i Komunës së Malishevës.
2. Të ketë së paku **20 krerë dele, ose dhi qumështore**, në prodhimtarinë aktive të qumështit.
3. Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e shkruar nga fermeri dhe numri kontaktues i telefonit
2. Kopjen e letërnjoftimit.
3. Regjistrin për vitin 2023 i lëshuar nga Praktikat veterinarë të kontraktuara nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet (origjinale ose kopje të vitit 2023).
4. Vërtetimi i tatimit në pronë.

Afati i aplikimit nga data 13.04.2023 deri më 28.04.2023

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën e pritjes në Komunë.
Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drejtori
Sylë DUKOLLI ecc.dip.